

- 1) Merret një copë letër dhe paloset më dysh për tre herë rradhazi dhe pastaj i bëhet një vrimë në mes me majën e një lapsi. Kur e hapim letrën, sa vrima do të jenë në të?  
 A) 1                                  B) 8                                  C) 6                                  D) 3
- 2) Cili nga çiftet e mëposhtme të fjalëve plotëson saktë fjalinë: “Ndonëse njihej si person ....., fjalimi i tij në kongres ishte shumë .... .”?  
 A) erudit, brilant                                  B) i drejtë, jokorrekt  
 C) i ndrojtur, i nënshtruar                                  D) inteligjent, kritik
- 3) Zgjidh alternativën, e cila rendit objektet sipas lartësisë në metra, duke filluar nga objekti me lartësi më të ulët:  
 A) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York  
 B) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York  
 C) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York  
 D) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York
- 4) Nëse: Elio ka lindur përpara Françeskës, e cila ka lindur përpara Gjergjit. Gjithashtu, edhe Iliri ka lindur përpara Gjergjit. Atëherë...  
 A) Iliri është më i vjetri në moshë.  
 B) Iliri dhe Françeska kanë të njëjtën moshë.  
 C) Elio dhe Françeska kanë me siguri mosha të ndryshme.  
 D) Është e sigurt që Elio është më i madhi.
- 5) Cilët numra duhet të zëvendësojnë pikëpyetjet?

4	7	1
5	1	3
9	8	4

A) 3 1 8

5	1	3
2	8	5
7	9	8


B) 4 1 8

1	2	6
2	9	2
?	?	?

C) 5 1 4

D) 6 2 4

6) Në figurë paraqitet rruga që nisim për t'i brendashkruar rrethit:



- A) Gjashtëkëndorin      B) Pesëkëndorin      C) Shtatëkëndorin      D) Dhjetëkëndorin

7) Cili nga vendet e mëposhtme nuk bën pjesë në zonën Shengen?

- A) Zvicra      B) Islanda  
C) Mbretëria e Bashkuar      D) Finlanda


8) Në një kuti ka 4 zara të bardhë, 3 zara të verdhë dhe 7 zara jeshilë. Sa është probabiliteti që të nxjerrim nga kutia në mënyrë rastësore, një zar të bardhë ose një zar jeshil?

- A)  $11 / 14$       B)  $4 / 14$       C)  $1 / 14$       D)  $1 / 2$

9) Cili kryeqytet europian nuk u pushtua nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore?

- A) Praga      B) Roma      C) Moska      D) Parisi

10) Cila është kutia që mungon?



- A)      B)      C)      D)

11) Në shkallën 5:1, në cilën përmasë do të vizatohej segmenti 2 cm?






- A) 10 cm      B) 1 m      C) 2.5 cm      D) 0.4 m

- 12) Nëse pohimi “Të gjithë atletët vrapojnë shpejt” është jo i vërtetë, atëherë detyrimisht:
- A) Asnjë atlet nuk vrapon shpejt                                      B) Të paktën një atlet nuk vrapon shpejt  
 C) Të gjithë atletët vrapojnë ngadalë                                  D) Të paktën një atlet vrapon shpejt
- 13) Cili prej kombinimeve të mëposhtme nuk është i saktë:
- A) David Selenica-piktor    B) Violeta Manushi-aktore  
 C) Ibrahim Kodra-shkrimtar    D) Petro Marko-shkrimtar
- 14) Katedralja “Notre Dame” në Paris është e stilit:
- A) Romanik                                      B) Barok                                      C) Të rilindjes                                      D) Gotik
- 15) Për cilin nga zhanret e pikturës njihet më shumë artisti i njohur shqiptar Vangjush Mio?
- A) Peizazhin                                      B) Figurat nudo                                      C) Natyrën e qetë                                      D) Portretin
- 16) Nëse është e vërtetë që të gjithë lapsat që kam janë të kuq përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë blu përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë të zinj përveç dy prej tyre, sa lapsa kam?
- A) Dy                                      B) Katër                                      C) Tre                                      D) Një
- 17) Cilat nga veprat arkitektonike të mëposhtme nuk është vepër e Antoni Gaudít?
- A) Pavijoni i Barcelonës    B) Shtëpia Milà  
 C) Parku Güell    D) Kisha “Sagrada Familia”
- 18) Kush nga arkitektët e mëposhtëm është i njohur për realizimin e veprës “Shtëpia në kaskadë”, ilustruar më poshtë?



- A) Le Corbusier                                      B) Walter Gropius  
 C) Alvar Alto                                      D) Frank Lloyd Wright

19) Cila është kutia që mungon?



20) Një litër lëng në temperaturën  $10^{\circ}\text{C}$  përzihet me gjysmë litri të të njëjtit lëng me temperaturë  $40^{\circ}\text{C}$ . Temperatura e ekuilibrit është:

A)  $25^{\circ}\text{C}$

B)  $20^{\circ}\text{C}$

C)  $40^{\circ}\text{C}$

D)  $30^{\circ}\text{C}$

21) Cili është autori i romanit “Harku i Triumfit”?








A) Stefan Zweig

B) Mark Twain

C) Erich Maria Remark

D) Ismail Kadare

22) Është dhënë trupi në aksonometri. Përcaktoni dy projektionet që i mungojnë tek paraqitja me projektione.




A) V-3; W-4

B) V-2; W-4

C) V-5; W-6

D) V-1; W-3


23) Imazhi më poshtë ilustron:



A) Asnjë nga alternativat më sipër  
C) Një obelisk

B) Një zigurat  
D) Një piramidë

24) Sa është kuota horizontale në sheshpushim në planimetrinë e dhënë të shkallëve ?




A) -1.53 m

B) +5.27 m

C) +5.02m

D) +1.87 m


25) Lidhni paraqitjen me projeksione me paraqitjen aksonometrike përkatëse të trupit gjeometrik.



A) 3B, 4A, 5E, 6F, 1C, 2D  
C) 2C, 3F, 4D, 5E, 6A, 1B

B) 4C, 5E, 6F, 1D, 2B, 3A  
D) 5B, 6E, 3D, 4C, 1F, 2A

26) Sa trekëndësha mund të numëroni në figurë?



A) 33                                      B) 12                                      C) 32                                      D) 24



27) Në cilin prej kongreseve u vendos alfabeti, me të cilin shkruhet edhe sot gjuha shqipe?

- A) Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe                                      B) Kongresi i Manastirit  
C) Kongresi i Përmetit                                      D) Kongresi i Lushnjës


28) Piramida e Tiranës i është ushtruar një transformimi së fundmi duke zbatuar projektin e realizuar nga studio e mëposhtme prestigjioze e arkitekturës:

A) MVRDV                                      B) UNStudio                                      C) Mecanoo                                      D) OMA


29) Cila nga paraqitjet është projeksioni i saktë në horizontal i trupit të prerë me dy plane?




1



2



3



4

A) 2

B) 3

C) 4

D) 1

30) Pushtimi i Kostandinopojës nga Perandoria Osmane ndodhi në:


A) 1744

B) 1453


C) 1321

D) 1590


31) Cili prej trupave në aksonometri korrespondon me paraqitjen në dy projeksione në V dhe H ?



A) 4




B) 3



C) 2



D) 1



32) Cili prej lumenjve të mëposhtëm kalon në Paris?

A) Elba

B) Danubi

C) Sena

D) Tamizi

33) Gjeni si mund të vazhdojë sekuenca e mëposhtme:

2 — 3 — 5 — 9 — 17 — 33 — ...

A) 56

B) 99

C) 67

D) 65

34) Përmasat e formatit A6 të vizatimit janë:

A) 105 mm x 148 mm

B) 106 mm x 149 mm

C) 106 mm x 148 mm

D) 105 mm x 149 mm

35) Cila nga fjalët e mëposhtme duhet vendosur në vend të pikëpyetjes?

Kama	Ajër	Nder	Alarm
Arra	Rosa	Ëndërr	Sonte
Mësim	Artist	Nëna	?

A) Ndërtues

B) Dash

C) Irracional

D) Raketë

36) Një kuti është e ndarë në pesë nëndarje drejtkëndore të barabarta të vendosura në mënyrë të tillë që brinja gjatësore e një nëndarjeje është në kontakt me 4 brinjët anësore të katër nëndarjeve të tjera. Perimetri i kutisë është 144 cm. Cilat janë dimensionet në centimetra të një nëndarjeje?

A) 9 x 36

B) 8 x 32

C) 7 x 28

D) 6 x 24

37) Përzgjidhni alternativën, e cila përshkruan më mirë funksionin e objektit të ilustruar më poshtë:



A) Opera


B) Banesë kolektive

C) Muze

D) Pallat sporti








38) Për të skicuar me dorë të lirë këndin e ngushtë, mbi një vijë horizontale fillojmë nga një pikë **0**, duke vendosur segmentin njësi, disa herë deri tek pika **a**. Më tej, tek pika **a** ndërtojmë një vijë vertikale duke vendosur segmentin njësi disa herë, deri tek pika **b**. Bashkojmë **0** me **b**. Këndi përballë brinjës **ab** është këndi i ngushtë i kërkuar. Për të ndërtuar këndin  $60^\circ$ , sa segmente njësi duhen vendosur në vijën horizontale dhe sa në vijën vertikale?



- A) 3 njësi dhe 2 njësi
- C) 3 njësi dhe 5 njësi

- B) 3 njësi dhe 6 njësi
- D) 3 njësi dhe 4 njësi

39) Cila është kutia që mungon?



40) Kush është krijuesi i “Modulorit”, sistemit universal të matjes i cili bazohet në proporcionet e trupit të njeriut?

- A) Frank Lloyd Wright
- C) Le Corbusier

- B) Ludwig Mies van der Rohe
- D) Frank O. Gehry

41) Një trup lihet të bjerë vertikalisht nga prehja nga një lartësi e caktuar dhe fiton në fund të lëvizjes një energji kinetike  $E$ . Sa bëhet energjia kinetike nëse masa e trupit dyfishohet?

- A)  $E/2$

- B)  $E$

- C)  $2E$



- D)  $4E$

42) Cilat shkronja duhet të zëvendësojnë pikëpyetjen?

HË	MA
MË	ENJ
PR	SHT
DI	?

- A) HË                      B) DI                      C) MA                      D) SHT

43) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione për figurën gjeometrike të dhënë në aksonometri ?



- A) 4                      B) 1                      C) 2                      D) 3

44) Kush është autori i veprës “Motra Tone”, ilustruar në figurën më poshtë?

- A) Alush Shima                      B) Kolë Idromeno                      C) Vangjush Mio                      D) Ibrahim Kodra

45) Vepër e kujt artisti është piktura e titulluar “Lulëzimi i pemës së bajames”, ilustruar në figurën mëposhtë?



- A) Henri Matisse
- C) Vincent van Gogh



- B) Paul Cézanne
- D) Paul Gauguin

46) Cila nga veprat e mëposhtme nuk është e Leonardo da Vinci-t?

- A) “Mona Lisa”
- C) “Darka e fundit”

- B) “Njeriu Vitruvian”
- D) “Kapela Sistine”

47) Në figurë paraqitet rrafshi në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?



A) 3

B) 1

C) 4

D) 2

48) Cila nga urat e mëposhtme nuk i përket ndërtimeve të mesjetës?

- A) Ura e Zogut, Milot
- C) Ura e Golikut, Pogradec



- B) Ura e Bratajt, Vlorë
- D) Ura e Mesit, Shkodër

49) Regjizor i cilit prej filmave të mëposhtëm është Dhimitër Anagnosti?

- A) Vdekja e kalit
- C) I dashur armik

- B) Koncert në vitin 1936
- D) Përrallë nga e kaluara


50) Plotësoni saktë pamjen e tretë në paraqitjen me projeksione të trupit gjeometrik.



1



2



3



4

A) 2

B) 4

C) 1

D) 3

51) Një klasë me 40 nxënës duhet të ndahet për një projekt në grupe të vogla me nga 3, 4 ose maksimumi 5 nxënës. Sa është numri maksimal i grupeve që mund të formohen?


A) 12

B) 11

C) 8

D) 13

52) Sa është sipërfaqja në  $m^2$  e dhomës së paraqitur në plan referuar përmasimit të dollapit në cm?



A)  $13.2 m^2$

B)  $14.4 m^2$

C)  $11.025 m^2$

D)  $8.1 m^2$

53) Një djalë me motor ndjek shokun, i cili është me biçikletë. Pas sa kohe takohen, nëse shpejtësia e dy mjeteve është respektivisht  $40 km/h$  dhe  $20 km/h$  dhe në çastin e dhënë janë  $500 m$  larg njëri tjetrit?

A) 3 minuta

B) 1 orë

C) 60 sekonda

D) 90 sekonda

54) Në fletët e vizatimit teknik të një objekti apo detaji vendoset si rregull shkalla e vizatimit. Kur ajo është shënuar 2:1, tregon:

A) Shkallë natyrale.

B) Shkallë zvogëlimi.

C) Shkallë zmadhimi.

D) Shkallë kopjimi.

55) Një ditë pyeta shokët se në cilin muaj do të vinte shfaqja e cirkut në qytet; ja si m'u përgjigjën secili prej tyre.

Beni: Ky muaj ka 31 ditë.

Aldo: Ky muaj ka 5 gërma.

Edi: Ky muaj ka dy shkronja njësoj.

Klea: Ky muaj mbaron me shkronjën R.

Tomi: Ky muaj ka dy zanore të ndryshme.

Ela: Ky muaj ka 30 ditë.

Nëse vetëm njëri prej tyre po gënjen: Cili është muaji në të cilin vjen cirku e që po flasin shokët?

A) Nëntor

B) Tetor

C) Janar

D) Korrik

56) Nga veprat e mëposhtme përzgjidh atë që nuk i përket piktorit Pablo Picasso.



A)



B)



C)



D)

57) Identifiko fjalën për t'u eliminuar si jokohereente me të tjerat:

A) Gjarpër

B) Balenë

C) Lakuriq nate

D) Lepur

58) Tapeti i një dhome është i ngjyrosur në këtë mënyrë:  $\frac{1}{3}$  është me ngjyrë të zezë,  $\frac{1}{4}$  me ngjyrë të kuqe, ndërsa pjesa tjetër me ngjyrë të bardhë përbën 8 metra katrorë. Sa është sipërfaqja e tapetit nëse e shënojmë me X?


A)  $X=8 \text{ metra}^2$

B)  $X=96 \text{ metra}^2$

C)  $X=5/12 \text{ metra}^2$

D)  $X=96/5 \text{ metra}^2$

59) Sa është lartësia e një këmbë shkalle në prerjen e dhënë, kur lartësia e katit është 3.24m ?



A) 17.5 cm

B) 18.5 cm

C) 17 cm

D) 18 cm

60) Cili qytet ishte qendra e artit evropian në fillimet e shekullit të 20-të?

A) Parisi

B) Vjena

C) Amsterdami

D) Londra

## Answer Key

Testname: UNTITLED1

- 1) B
- 2) B
- 3) B
- 4) C
- 5) B
- 6) D
- 7) C
- 8) A
- 9) C
- 10) A
- 11) A
- 12) B
- 13) C
- 14) D
- 15) A
- 16) C
- 17) A
- 18) D
- 19) A
- 20) B
- 21) C
- 22) D
- 23) B
- 24) B
- 25) D
- 26) C
- 27) B
- 28) A
- 29) A
- 30) B
- 31) A
- 32) C
- 33) D
- 34) A
- 35) C
- 36) B
- 37) A
- 38) C
- 39) D
- 40) C
- 41) C
- 42) A
- 43) C
- 44) B
- 45) C
- 46) D
- 47) C
- 48) A
- 49) D
- 50) C
- 51) D
- 52) B
- 53) D
- 54) C

Answer Key

Testname: UNTITLED1

55) B

56) B

57) A

58) D

59) D

60) A